VENDIM
Nr. 3, datë 5.1.2018

PËR SHQYRTIMIN E REZULTATIT TË VERIFIKIMIT TË PROKURORISË SË PËRGJITHSHME PËR FUNKSIONARIN PUBLIK Z. GLEDJON REHOVICA, ME DETYRË DEPUTET I KUVENDIT TË SHQIPËRISË, NË ZBATIM TË LIGJIT NR. 138/2015, "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 5.1.2018, me pjesëmarrjen e:

Klement	Zguri	kryetar
Denar	Biba	zëvendëskryetar
Bledar	Skënderi	anëtar
Edlira	Jorgaqi	anëtare
Vera	Shtjefni	anëtare,

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e rezultatit të verifikimit të Prokurorisë së Përgjithshme për funksionarin publik z. Gledjon Rehovica, me detyrë deputet i Kuvendit të Shqipërisë, të subjektit politik Partia Lëvizja Socialiste për Integrim, Qarku Berat, në zbatim të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

BAZË LIGJORE: Neni 23, pika 1, germa "a", i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; neni 10, pika 1, germa "d", i ligjit 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreu III, pika 3, germa "ç", i vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar; nenin 10, pika 1, germa "d", të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", dhe kreut III, pika 3, germa "ç", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike",

VENDOSI:

1. Të shpallë të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit z. Gledion Tomorr Rahovica.

2. Ky vendim t'i njoftohet menjëherë Kryetarit të Kuvendit.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

KRYETARI
Klement Zguri